Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Genc Zogaj	**13.10.2023**	**27.10.2023**	**2023/0776**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.10.2023, OE "NARA BIOTICS SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0776, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "PRO MEDICAL SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material stomatologjik" me nr. të prokurimit: "632-23-8446-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: **30,000.00** €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0776 i dt:09.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1; Qëllimi

Neni 6; Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7; Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

AK KK Gjakovës me datën 27.09.2023 ka bërë publikimin e Njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull ***"Furnizim me material stomatologjik"*** dhe me numër të prokurimit ***632-23-8446-1-2-1. Përmes këtij njoftimi jemi njoftuar se jemi eliminuar për këto arsyje:***

1. ***Nuk ka dëshmi transaksionin banker që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.***
2. ***Kontrata e nënshkruara nuk mund të merren për bazë.***

KRITERET PËR VLERËSIM

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 45.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme.

Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve, në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

B58 - NJOFTIM MBI RI-VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Furnizim me material stomatologjik

Nr. i prokurimit	**632-23-8446-1-2-1**
Nr i brendshëm	**632-23-128-121**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	**NARA BIOTICS SH.P.K., Rr.Mbretëresha Teutë,, 10000, Prishtine**	**320,19€**
2.	**PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj**	**730,83€**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Komuna e Gjakove **shpërblen** me kontratë: **PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj,** në vlerë prej **730,83€ sipas çmimit më të ulët me peshim.**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NARA BIOTICS SH.P.K.**

OE ankues pretendon se AK pa te drejte e ka eliminuar nga procedura ne fjale duke dhene sqarime si ne vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

- Ju si Operatorë Ekonomik, keni prezentuar dokumentat e kërkuar, por pas shiqimit të dokumentacionit keni prezentuar kontratat në të cilën ceket se hyn në fuqi me dt.02.05.2023 dhe në kontratë ceket se kjo referencë është e vlefshme nga data 15.08.2021 deri 30.04.2023 dhe nuk ka dëshmi transaksionin bankar që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.

Pergjigje ne pretendimin ankimor:

Pas shqyrtimit te dokumentacionit te derguar dhe sqarimeve shtese eksperti veren qe dokumenti i paraqitur si kontrate nga ana e kompanise ankuese NARA Biotics dhe MATKOS Fharm ka shume paqartesi ku ne titull shkruhet qe eshte kontrate pastaj brenda ne tekst shkruan qe eshte Reference e vlefshme nga 15.08.2021 deri me 30.04.2023 dhe me tutje nje paragraf ku shkruan qe kjo kontrate hyn ne fuqi me date 02.05.2023. Pra eshte e pa qarte edhe per ekspertin se a eshte kjo kontrate per furnizim apo reference.

KONTRATË PER: Furnizim me paisje material shpenzues per Stomatologji

Nr.i kontrates: 07/2023

- Nara Biotics me nr unik: 811379719 me seli në Prishtinë adresa Mbretëresha Teutë , e cila përfaqësohet nga z.Bashkim Preniqi në cilësinë e Drejtorit të përgjithshëm (tani e tutje: Pala 1)
- Matkos Pharm, me nr. unik: 811159624 me seli në Prishtinë, Shpetim Robaj. Nr.289, e cila përfaqësohet nga Kastriot Vitija, në cilësinë e Pronarit (tani e tutje: Pala 2)
- Kjo Referencë është e vlefshme nga data 15.08.2021 deri 30.04.2023.
- Me titull Furnizim me paisje material shpenzues per Stomatologji 446,567.76.€

nara biotics

Kjo Kontratë hynë në fugi me datë: 02.05.2023.

Secila pale ka të drejtë që të bëjë zgjidhjen e kësaj Kontrate, pa ndonjë arsye dhe

Ne pretendinim ankimor tjeter per te cilen eliminuar OE ankues eshte se ai nuk i ka dorezuar transakcionet bankare apo situacionet e pranimit lidhur me keto kontrata. Ne kete rast OE ankues pretendon se keto transakcione bankare gjinden tek dokumendi 02. faqe 16 te cilen eksperti e ka kontrolluar dhe ka gjetur kete leter dokument e leshuar nga Banka Raiffeisen e cila leter tregon verteton vetem qarkullimin vjetor bankar te Operatorit dhe jo transaksionet e sakta apo transfere dhe pagesa te cilat vertetojne kontraten dhe liferimin e lartecekur. Pra keto dy dokumente dallojne teresisht nga ajo cka eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit nga AK.

Raiffeisen BANK

To: Whom it may concern

Subject: Bank account confirmation

Date: 14.08.2023

Hereby we confirm that company **NARA BIOTICS SH.P.K.** with owner Mr. **BASHKIM PRENIQI** is our client with current account **1501001019732996** EUR.

For the period 01.01.2021 until 31.12.2021 the company made turnover through RBKO account in amount of **229,224.70 Eur.**

For the period 01.01.2022 until 31.12.2022 the company made turnover through RBKO account in amount of **467,645.00 Eur.**

For the period 01.01.2023 until 14.08.2023 the company made turnover through RBKO account in amount of **65,411.27 Eur.**

We hope this information is sufficient for you.

Me respekt,
Gëzim Noti
SE Support Officer
Corporate Banking Department

RAIFFEISEN BANK KOSOVË J.S.C. RBKO RAIFFEISEN BANK KOSOVO J.S.C.

Andaj duke pare rrethanat dhe faktet eksperti konsideron qe pretendimet e OE ankues **jane te pabazuara.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E GJAKOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NARA BIOTICS SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Genc Zogaj